



## E K S T R A K T

**i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 20.11.2023, me fillim në orën 10:00**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok dhe Faton Marolli.

**Munguan:** Arton Brahim, Tiera Kasumi Berisha, Oktay Kurtesh.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Arianita Beqa Rraci, zyrtare nga UNMIK-u, Diellza Azemi, zyrtare nga OSCE, Fisnik Dida, zyrtar nga OSCE.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete me këtë ;

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë Musmurati (U.D Donjeta Sahatçiu), Raport për gjendjen e nxënësve nga komunitetet joshumicë në shkolla;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale z. Krenar Xhaferi, të na njoftojë lidhur me kërkesat e realizuara dhe të parealizuara për vitin 2023;
4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Sportit z. Granit Rugova;
5. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku;
6. Formimi i Komisionit për hartimin e raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
7. Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës së Komitetit për vitin 2024;
8. Raporti i ZKKK-ës për muajin tetor 2023;
9. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
10. Të ndryshme.

**Pika e pare**

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së**

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Pika e dytë**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë Musmurati (U.D Donjeta Sahatçiu), Raport për gjendjen e nxënësve nga komunitetet joshumicë në shkolla**

**Mirsada Behluli** - pasi që njoftoi z. Vrapca me gjetjet e komisionit lidhur nga vizitat në shkolla ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë tha se për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia jap z. Lulzim Vrapcës që të na njoftojë lidhur me gjendjen e nxënësve nga komunitetet joshumica në shkolla.

**Lulzim Vrapca** – lidhur mbi çështjen e shtruar edhe si raport mbi gjendjen e nxënësve të komuniteteve joshumicë në shkollat e Komunës e Prishtinës tha se Komuna e Prishtinës, Drejtorja e Arsimit ka organizuar trajnime gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në shkollat ku vijnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë e para. E dyta, lidhur me komunitetin boshnjak për konkurse këtë që e tha kryesuesja nuk qëndron, mund të hyni në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës, ku më datë 14 qershor ka qenë i shpallur vendi për punë për Histori dhe Edukatë Qytetare (paralelja boshnjake). Këto konkurse janë duke u përsëritur prej 2-3 viteve radhazi pse nuk është rekrutuar sepse nuk ka pasur kandidatë të kualifikimeve profesionale që e kërkon Udhëzimi Administrativ mbi kuadrin e përgjithshëm të kuadrit arsimor. Që të jemi më të qartë me shkenca politike nuk mundet me u dhënë edukatë qytetare dhe histori. Ai mes tjerash tha se te shkolla fillore “Emin Duraku” javën e kaluar i kemi dorëzuar 25 laptop, d.m.th është bërë kabineti i informatikës, kemi pasur fat që kemi pasur kontakt me njësi p.sh Arizona University dhe si donacion ka ardhur te shkolla që d.m.th Arizona University ka donuar me ata laptop, kurse sa i përket komunitetit turk tha se më lejoni të përmendi që kabinetet e robotikës, orët e dekodimit i kemi kushtuar rëndësi të veçantë rrjedhimisht edhe në shkollën “Elena Gjika”. Ideja është pra që ky kabinet të inkorporohet në kuadër të Elena Gjikës, por jo të punohen objektet e reja. Pasi që e dimë se nuk lejohet të ndërtohet në atë zonë pasi që është zonë e mbrojtur. Pra në shkollën “Elena Gjika” do të ketë kabinet të tillë jo vetëm i robotikës, por edhe i teknologjisë, ndërsa për marrëveshjet tjera, të cilat janë për renovim për mësim që e përmendet për komunitetin turk të “Prenk Jakova” lidhur me TIKA, ne jemi të hapur për këto bashkëpunime, por së pari duhet të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit Drejtorja e Arsimit me TIKA, e pastaj të specifikohen ato kushte, përgjegjësitë, detyrimet për të cilat ne jemi të hapur kështu që e shohim se çfarë është ajo ideja për këtë, përndryshe për mësim shtesë ka edhe në shkollën “Ali Sokoli” pra mësimi shtesë është mësim shtesë, janë mësimdhënësit që e zbatojnë kornizën kurrikulare të Kosovës. Kurrikulën bërthamë që është pjesë integrale e kornizës ligjore të arsimit. Prandaj ju kisha lutur juve si komunitet, ne kemi pasur kontakt edhe me shkollën, kemi pasur kontakt me i inkurajuar ata të cilët janë të kualifikuar nga komuniteti boshnjak që të aplikojnë.

**Mirsada Behluli**– lidhur me koordinatoren tha se ata janë këmbëngulës dhe çdoherë kërkojnë ashtu që nëse kishim mundur me ju dhënë përgjigje, nëse mundeni tani po që nuk mundeni ju e shihni sipas ligjit.

**Lulzim Vrapca** - tha se nuk ka koordinatore të përcaktuar askund për cilindo komunitet. Ai në vazhdim tha se më e rëndësishmja është me u rekrutuar stafi, e merrni normativin e përgjithshëm edhe mundeni ta shihni se nuk ekziston asnjë pozicion i tillë koordinator. Ato janë çështje të brendshme të komuniteteve që munden me i organizuar brenda për shkolla, struktura, organogrami, hierarkia janë

drejtor, sekretar, psikolog, stafi mbeshtetes dhe jane mesimdhenesit, nuk ka koordinatorë te komuniteteve.

**Elmira Nikçi Rexha** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se kryesuesja e ka përmendur edhe një kërkesë që ka të bëjë me vendosjen e një objekti me skelet të përkohshëm për kabinetin e robotikës tek shkolla “Elena Gjika” sepse kanë marrë donacione dhe kanë vendosur që t’i vendosin jashtë ato që me qenë në kuadër të xhamave që me u pa një projekt që e kanë bërë vetë ata. Meqë e kanë bërë kërkesën në drejtori qysh në fund të shtatorit, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje as nga Drejtoria e Arsimit e as nga Drejtoria e Inspektionit.

**Lulzim Vrapca** – tha se nuk po e di për çfarë përgjigje është fjala se nuk ka gjasa mos me kthyer përgjigjen se krejt përgjigjet i kthejmë.

### **Pika e tretë**

#### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale z. Krenar Xhaferi, të na njoftojë lidhur me kërkesat e realizuara dhe të parealizuara për vitin 2023**

**Nenad Mildinovic** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se sa i përket projekteve të cilat i realizon Drejtoria e Investimeve Kapitale tha se përmes kësaj drejtorie po punohet shumë në Bërnice, janë disa projekte nga më herët, është në pyetje asfaltimi i rrugës kryesore në gjatësi prej dy kilometrave. Pas kësaj është dashur të bëhet edhe kullimi për shirat atmosferike dhe për shkak të zgjerimit të rrugës po punohet rreth shtratit të lumit në gjatësi prej 150 metra, ashtu që këto janë disa punë shtesë të cilat e kanë zgjatur punën, ndërsa sa i përket këtij projekti në gjatësi prej 250 metra nuk është ai trotuar, por asfaltimi i rrugës, punimet janë në vazhdim, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike puna është ndalur, mirëpo punimet janë në vazhdim e sipër, kurse sa i përket ujësjellësit në Slivovë ajo nuk i përket Drejtorisë së Investimeve Kapitale, ajo i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Ata e kanë marrë këtë pjesë të punës, mirëpo sa unë e di në këtë projekt nuk është bërë ende asgjë. Ai në vazhdim tha se ka edhe disa projekte në Bërnice të Poshtme, të cilat nuk shkojnë përmes kësaj ZKKK-ës, por direkt shkojnë përmes Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe bëhet fjalë për rregullimin e disa shtretërve të lumit kur janë në pyetje të reshurat e mëdha, kështu që unë mendoj se kjo ka shkuar përmes urdhëresës së kryetarit pasi që kryetari vetë i ka vizituar ato vende. Në fund tha se me rëndësi është se po punohet shumë nga Drejtoria për Investime Kapitale dhe shpresojmë se kur të përmirësohet koha këto punë do të përfundojnë.

**Mirsada Behluli** - tha se për shkak të raportit kam disa pyetje, a ka pasur zhvendosje të stacionit të autobusit në rrugën Prishtinë – Podujevë për 50 metra, a është rregulluar ajo pjesë?, a janë vendosur shenjat e komunikacionit në Bërnice të Poshtme?, a është bërë pastrimi i shtratit të lumit?, dhe a janë pastruar deponitë.

**Nenad Milladinovic** - tha se tani është duke u punuar rruga kryesore Prishtinë – Podujevë pra zgjerimi i rrugës ku mendoj se me ato punime do të zgjidhet ai problem, sepse është problemi se stacioni nuk mund të zhvendoset derisa punimet janë duke u bërë. Sa i përket vendosjes së shenjave tha se nuk janë vendosur pasi që janë duke u kryer punimet, që mendoj se kur të përfundojnë punimet do të vendosen edhe shenjat e komunikacionit, kurse sa i përket pastrimit të shtratit të lumit tha se është dashur të fillohet me punë, por shkak se pse është ndërprerë ajo është se sipas informatave që kam nuk e di a janë të sakta apo jo se është e dashur të punohet njëkohësisht me pastrimin e lumit edhe sistemi qendror i kanalizimit i cili kishte me i mbledhur të gjitha ujërat e zeza, do të thotë nga pjesa e Vranjevcit, Bërnices së Poshtme, Trudës, ku sipas meje është logjike që të bëhet njëherazi e gjithë ajo. Sa i përket

deponive ajo ende paraqet problem te madh, ende ajo gjendet ne nyrje te ishanit e cila nuk eshte pastruar me vite qe ndoshta edhe kjo eshte arsyeja qe ka shume qene endacakë në atë pjesë.

**Kimeta Shok** – tha se nuk kemi diçka konkrete, kurse sa i përket pastrimit të deponive tha se janë katastrofale si p.sh rruga “Çajupi” në lagjen Tophane.

**Nenad Miladinovic** – tha se sa i përket kompanisë së pastrimit nuk kemi problem sepse ata e kryejnë punën e vet, mirëpo për deponitë ilegale përgjegjëse është Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke shtuar se këtë duhet ta sqarojmë që mos ta hedhim fajin tek kompania e cila e kryen punën e mbledhjes së mbeturinave.

#### **Pika e katërt**

##### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Sportit z. Granit Rugova**

Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njërin prej takimeve të ardhshme.

#### **Pika e pestë**

##### **Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku**

**Mirsada Behluli** – shtroi disa pyetje për drejtorin e shëndetësisë z. Sadiku siç vijojnë: ofrimi i shërbimeve shëndetësore për komunitetet joshumicë; zbatimi i vaksinimit të komuniteteve ashkali dhe rom, dhe mundësisht të na informoni se çka ju konsideroni se ne si komunitete joshumicë duhemi të jemi të informuar, si dhe na intereson të gjithëve përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në sistemin shëndetësor, të cilët punojnë në kujdesin parësor shëndetësor. Ajo në vazhdim tha se te komuniteti boshnjak kemi një kandidate e cila ka kryer Bachellorin për fizioterapeut, si dhe ka të kryer dy mastera, prandaj desha t’ju pyes se kjo Qendra e fizioterapisë në Pallatin e Rinisë a i takon Shtëpisë së shëndetit apo SHSUK-së.

**Izet Sadiku** – lidhur me pyetjet e shtruar nga znj. Behluli tha se ju e dini një ndër kriteret për me dhënë shërbimin shëndetësor është trajtimi i barabartë për të gjithë qytetarët, dhe se deri tash nuk kemi pasur asnjë vërejtje prej qytetarëve të komuniteteve joshumicë se nuk i është dhënë shërbimi, si dhe nuk kemi pasur asgjë specifike, ndërsa sa i përket çështjes së vaksinimit tha se ai ka vazhduar si proces i rregullt te ne, d.m.th e dini që ka ndryshuar sivjet në fakt prej vitit të kaluar bëhet distribuimi i vaksinimit në çdo Qendër të Mjekësisë Familjare pra në 14 QMF. Tutje tha se për ata qytetarë të cilët nuk mund të shkojnë të marrin shërbimin, atëherë ekipi i vaksinimit shkon në shtëpi dhe e bënë vaksinimin, kështu që deri tani nuk kemi pasur asnjë ankesë për diçka që është kërkuar ndonjë ndihmë qoftë edhe prej komuniteteve që nuk i është dhënë ndihma. Ai në vazhdim tha se ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë edhe nëse ka me pasur kërkesa edhe përmes komunitetit të juaj ne me shkuar me e dhënë shërbimin, për arsye se ne nuk e dimë lokalitetin se ku ka nevojë dhe ku jetojnë ata që me e pasur ndonjë qasje të veçantë ndaj tyre. Mirëpo ju duhet të jeni të gatshëm për bashkëpunim nëse ka pasur propozime prej komuniteteve qoftë për vaksinim apo shërbime tjera që mundemi me ju ndihmuar. Ne i kemi treguar dhe ju kemi thënë edhe zyrtarëve të m’i që sa i përket çështjes së mamografisë në qoftë se ka pasur interesim prej grupeve të caktuara t’i ftoni. Pra kjo është qasja që e kemi ne, edhe për diabet e kemi pasur javën e diabetit dhe kemi thënë se nëse ka të interesuar nga komunitetet joshumicë të na i jepni numrat kontaktues, si dhe mund të vijnë dhe t’i dëgjojnë ligjëratat. Pra po e përsëris edhe njëherë se gatishmëria e jonë është për të bashkëpunuar dhe përkrahur komunitetet në qoftë se kanë pasur kërkesa të veçanta. Lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Behluli tha se Qendra për fizioterapi në Pallatin e Rinisë nuk i takon Shtëpisë së shëndetit pasi që nuk kemi të drejtë të kemi fizioterapeut në mjekësinë

primare, pasi qe ne mjekesine primare mund te punesohen mirat, mjeket nga mjekesia familjare, biokimistë, radiologë ku as pediatri nuk mund të punësohet në Qendrat e Mjekësisë Primare.

#### **Pika e gjashtë**

#### **Formimi i Komisionit për hartimin e raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023**

Për këtë komision u propozuan Mirsada Behluli, Elmira Nikçi Rexha dhe Klaudia Mula, ku njëzëri u miratua nga anëtarët e Komitetit.

#### **Pika e shtatë**

#### **Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës së Komitetit për vitin 2024**

Për këtë komision u propozuan Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok dhe Klaudia Mula, ku njëzëri u miratua nga anëtarët e Komitetit.

#### **Pika e tetë**

#### **Raporti i ZKKK-ës për muajin tetor 2023**

Nuk pati diskutime rreth kësaj pike.

#### **Pika e nëntë**

#### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre**

**Nenad Miladinovic** – tha se unë çka pata i thash, sa i përket sigurisë nuk kemi kurrfarë problemesh, mirëpo problem janë qentë endacakë dhe moslargimi i deponive ilegale.

#### **Pika e dhjetë**

#### **Të ndryshme**

**Mirsada Behluli** – të pranishmit i informoi lidhur çështjen e anëtarit të komitetit z. Arton Brahimiri nga komuniteti shumicë, në ç'rast tha se është informuar se ai nuk do të jetë prezent në takime për një kohë të gjatë, si dhe me kënd mund të bisedohet se a mundet Komiteti të funksionojë pa një anëtar apo duhet bërë zëvendësimi i tij.

**Procesmbajtësja**  
**Lendita Spahija**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Dr. Mirsada Behluli**

